



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 321, datë 20.12.2019

PËR
RRIFILLIMIN E VEPRIMTARISË DHE SHËRBIMEVE GJYQËSORE TË GJYKATËS
SË RRETHIT GJYQËSOR LEZHË DHE TRANSFERIMIN E PËRKOZHËM TË
SELISË SË SAJ NË NDËRTESEN E PROKURORISË PRANË KËSAJ GJYKATE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 147, pika 1 dhe 147/a, pika 1, shkronja “d”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 61 të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në Ligjin nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, në Ligjin nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në Qarqet Durrës dhe Tiranë”, i ndryshuar, në Vendimin e Këshillit nr.267, datë 02.12.2019, “Për pezullimin e veprimtarisë dhe sherbimeve gjyqësore në gjykatat e Qarqeve Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, në kushtet kur ndërtesa e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë vijon të jetë e papërshtatshme për ushtrimin e veprimtarisë së saj, bazuar edhe në propozimin e Këshillit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë,

VENDOSI:

1. Rifillimin e veprimtarisë dhe sherbimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.
2. Transferimin e përkohshëm të Selisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë në ndërtesën e Prokurorisë pranë kësaj gjykate, në ambientet e vëna në dispozicion prej saj.
3. Në kushtet e ambienteve të kufizuara për ushtrimin e veprimtarisë dhe sherbimeve gjyqësore, Këshilli i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë të përcaktojë kategoritë e çështjeve gjyqësore për të cilat veprimtaria gjyqësore e kësaj gjykate rifillon menjëherë, duke vlerësuar dhe përcaktuar në vijimësi, sipas rastit dhe mundësisë, edhe çdo kategori tjetër çështjesh për të cilat veprimtaria e gjykatës rifillon.
4. Ngarkohet Kryetari dhe Këshilli i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR